



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201600806/6

Tiranë ___/___/2017

Lënda : *Rekomandohet kryerja e veprimeve përmbareme për lirimin dhe dorëzimin e objektit ndërtuar prej palës gjyqbjerrëse (debitore) mbi parcelën nr.50/3, me sipërfaqe 21275m2, pronë e gjyqfituesit V.M..*

Gjyqfitjen e palës gjyqbjerrëse (debitore) deri në 50000 Lekë në çdo rast deri në ekzekutimin e detyrimit të vendosur prej gjykatës.

Drejtuar : **Lindita Shaliani**
Kryetare e Zyrës së Përmbaremit,

FIER

Për dijëni : **Albert Pilo**
Drejtore i Përgjishëm i Shërbimit të Përmbaremit Gjyqësor
Shtetëror,

TIRANE

K.Xh
Adresa:

VLORE

Zj.Kryetare!

Me rastin e pranimit të ankesës të kryer prej ankuesit K.Xh., në te cilën prezantohet shqetësimi për mosekzekutimin e Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr.2083, datë 20.10.2012, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, për të cilin po kjo Gjykatë ka lëshuar Urdhërin e Ekzekutimit me Vendimin nr.221, datë 22.04.2014, me objekt midis të tjerave;

“Detyrimin e të paditurve, të njohin pronar paditësin për parcelën nr.50/3, me sipërfaqe 21275 m2, sipas planvendosjes së ekspertës Engjëllushe Sako në aktin e ekspertimit datë 16.05.2012, me kontur me ngjyrë të kuqe, në pronësi të paditësit e të lirojë dhe dorëzojë sendin paditësit në gjendjen që e ka marrë.

Detyrimin e të paditurve solidarisht t'i japin paditësit shumën prej 68000 Lekë për frutat civile të humbura prej tij, si pasojë e humbjes së posedimit të sendit prej datës 20.08.1995.

Detyrimin e të personit të tretë ZVRPP, Fier, të fshijë nga regjistrat hipotekor, pasurinë objekt konflikti të rregjistruar të të paditurve me sipërfaqe 2175 m2 në pronësi të V.M. sipas planvendosjes së ekspertës Engjëllushe Sako, me kontur me ngjyrë të kuqe”,

Institucioni i Avokatit të Popullit me shkresën K3/K10 10-2 Prot, datë 10.10.2016, ka kërkuar Zyrës së Përmbartimit, Fier, informacion dhe shpjegime rreth veprimeve përmbartimore të kryera si dhe shkaqeve të cilat mund të justifikojnë mosëkzekutimin deri më sot të Titullit Ekzekutiv të lartpërmendur.

Në përgjigjë të kërkesës, ju Zj.Kryetare, me shkresën nr.137 Prot, datë 14.10.2016, drejtuar Avokatit të Popullit, informoni mbi veprimet përmbartimore të kryera për ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr.2083, datë 20.10.2012, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier.

Referuar informacionit të dhënë nga ana juaj konstatojmë se, në mënyrë të padetyruar nga ligji janë kryer veprime përmbartimore të përsëritura, sikurse njoftimi i palës gjyqbjerrëse për përmbushjen e detyrimit në mënyrë vullnetre. Po kështu, konstatojmë se, veprimet përmbartimore për vjeljen e detyrimit në të holla në ngarkim të palës debitore, me rastin e përfundimit të afatit për dorëzimin në mënyrë vullnetare të këtij detyrimi, janë kryer pas 6(gjashtë) muash nga përfundimi i këtij afati, veprim i cili nuk mund të vlerësohet i rregullt. Në rastin e vjeljes së detyrimeve në të holla përmbartuesi gjyqësor medoemos duhet të mbaj parasysht parashikimin e kryer në nenin 519 të K.Pr.C. për fillimin e menjëhershëm të ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv në ngarkim të palës debitore, apo të nenit 527 të K.Pr.C. me rastin e konsumimit të afatit për zbatimin vullnetar të detyrimit. Do të duhej që në mbështetje të parashikimeve të kryera në Nenin 517 të K.Pr.C. përmbartuesi gjyqësor i çështjes të kërkonte nga pala debitore të deklaronte, me shkrim, gjendjen pasurore si dhe sendet ose kredi që persona të tretë i detyrohen.

Gjithashtu, në informacioni e dhënë, nuk konstatohet nëse është kryer verifikim për pasuri të sekuestrueshme në emër të palës debitore në banesën ku banon apo në ZVRPP, Fier. Përsa i përket detyrimit të palës gjyqbjerrëse për të liruar dhe dorëzuar pasurinë Nr.50/3, me sipërfaqe 2175 m2, konstatojmë se, janë kryer një numër veprimesh të pasuksesshme për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv. Kryerja e veprimeve përmbartimore për ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr.2083, datë 20.10.2012, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, rezultojnë jo efektive, në gjykimin tonë, për shkak të mosorganizimit dhe moskryerjes të veprimeve përmbartimore sikurse parashikuar në nenin 523, 606 të K.Pr.C., si dhe nenin 30 të ligjit nr.8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”, të ndryshuar. Ka qenë dhe është detyrim për përmbartuesin gjyqësor të çështjes të kërkojë në mbështetje të dispozitave ligjore të lartpërmendura bashkëpunimin e organeve të tjera shtetërore në ditën dhe orën e përcaktuar nga ana e tij, duke përmendur në shkresën zyrtare drejtuar organeve shtetëror sanksionet në rast mosprezantimi nga ana tyre të pamundësisë (gjithëmonë para ditës së ekzekutimit) për bashkëpunim. Mosparaqitja nga ana e përfaqësuesve të organeve shtetërore të provave që vërtetojnë pamundësinë e bashkëpunimit, para ditës dhe orës së kryerjes së veprimeve përmbartimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, ka përbërë dhe përbën shkak ligjor për vendosjen e sanksioneve ndaj personit përgjegjës, sikurse parashikuar në nenin 606 të K.Pr.C. Kjo procedurë nuk konstatohet të jetë respektuar në korespondencën e zhvilluar me IMT, pranë Bashkisë, Fier, apo IKMT, Tiranë. Mosrespektimi rigoroz i procedurës për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv prej përmbartuesit gjyqësor të çështjes

ka ndikuar në cënimin e parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse garantuar nga sanksionimi i kryer në nenin 42/2 të Kushtetutës apo nenin 6/1 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137/1996, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyësor në afat të arsyeshëm. Ndodhur në situatën e prezantuar nga ana juaj, vlerësojmë të domosdoshme kryerjen e veprimeve përmbarimore, sa më parë të jetë e mundur, për heqjen nga posedimi të ndërtimit që pala debitore ka të ndërtuar mbi pasurinë e palës gjyqfituese. Largimi i palës gjyqbjerrëse nga ndërtimi, është hap që ndihmon në arritjen përfundimtare të ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr.2083, datë 20.10.2012, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, pavarësisht pamundësisë së derisotme për prishjen e ndërtimit të kryer nga ana e palës gjyqbjerrëse. Kryerja e veprimeve të mëtejshme për prishjen e ndërtimit, me rastin e largimit të palës debitore nga ndërtimi, do të mund të kryhen edhe nga vetë pala kreditore në kuptim dhe zbatim të parashikimi të kryer në nenin 605 të K.Pr.C.

Mosekzekutimi prej afro 3(tre) vjetësh i Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr.2083, datë 20.10.2012, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, përbën shkak për ankuesin, t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese apo Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkeljen e së drejtës së pronësisë si dhe cënim të së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, të garantuara sipas nenin 41, 42/2 të Kushtetutës apo Neni 6/1 i Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, neni 1 i Protokollit nr.1, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, *“Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”*.

Ekzekutimi i titujve ekzekutiv brenda një afati të arsyeshëm është tashmë një standart i konsoliduar nga Gjykata Kushtetuese si dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Gjykata ka theksuar se e drejta për të kërkuar ekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, duhet konsideruar si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Nga këndvështrimi i parimeve kushtetuese, lidhur me procesin e rregullt ligjor, që burojnë nga nenet 42 dhe 142/3 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së, çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës dhe të vet nocionit të gjykimit të drejtë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre. Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të prekë thelbin e së drejtës.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin sanksionohet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozoj masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata Publike”*, si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, i cili parashikon se : *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDOJMË

Kryerjen e veprimeve përmbare për lirim dhe dorëzimin e objektit ndërtuar prej palës gjyqbjerrëse (debitore) mbi parcelën nr.50/3, me sipërfaqe 21275m2, pronë e gjyqfituesit V.M.

Gjohitjen e palës gjyqbjerrëse (debitore) deri në 50000 Lekë në çdo rast deri në ekzekutimin e detyrimit të vendosur prej gjykatës.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.

Bashkëlidhur ju dërgojmë kopje të shkresës nr.137 Prot, datë 14.10.2016, të Zyrës së Përmbaremit, Fier, drejtuar Avokatit të Popullit.

KOMISIONERI

Etilda GJONAJ(SALIU)